



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2023:000188

Datë: 16.02.2023

Numri i dokumentit: 03987043

PPP.nr.210/2022

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, si përbarimore, gjyqtari Avdulla Mecinaj me bashkëpunëtorin profesional Agron Geci, në çështjen juridike të kreditorit KUR “Mitrovica” Sh.a., J.S.C., me adresë “Rruga e Liqenit” pn.- Mitrovicë, kundër debitorit A.K., nga fshati..., komuna Skenderaj, për shkak të borxhit në shumë prej 284.67 euro, duke vendosur sipas prapësimit të ushtruar nga debitori kundër urdhrit përbarimor P.nr.473/22 të dt.05.12.2022, jashtë seancës gjyqësore me dt.16.02.2023, jep këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit A.K., nga fshati..., komuna Skenderaj, ushtruar kundër urdhërit mbi lejimin e përbarim P.nr.473/22 të dt.05.12.2022, sipas propozimit të kreditorit KUR “Mitrovica” Sh.a., me adresë “Rruga e Liqenit” pn.- Mitrovicë.

II. Mbetet në fuqi Urdhri përbarimor i përbaruesit privat P.nr.473/2022 i dt.05.12.2022.

A r s y e t i m

Kreditori KUR “Mitrovica” Sh.a., me adresë “Rruga e Liqenit” pn.- Mitrovicë, ka ushtruar propozimin për përbarim të përbaruesi privat, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përbarimi ndaj debitorit A.K., nga fshati..., komuna Skenderaj, për pagesën e borxhit për shërbimet e furnizimit me ujë, për periudhën kohore dt.01.01.2021 deri me dt.31.10.2022 në shumë prej 284.67 euro, me kamatë ligjore 8% nga dita e arritshmërisë për pagesë, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, të gjitha këto në afat 7 ditor nga dita e pranimit të urdhrit, në të kundërtën nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë bankare zyra përbarimore përmes regjistrimit, sekuestrimit, vlerësimit dhe shitjes së sendeve të luajshme dhe të

paluajtshme të debitorit dhe mjetet e mbledhura të transferohen në llogari të kreditorit, të gjitha këto të specifikuar në propozimin për përmbarim të dt.05.12.2022.

Përmbaruesi privat I.M. nga Mitrovica, me urdhrin përmbarimor P.nr.473/22 të dt.05.12.2022, e ka lejuar propozimin për përmbarim në këtë çështje përmbarimore.

Debitori, A.K., brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me shkrim, duke e kundërshtuar urdherin me anë të cilit është lejuar përmbarimi me pretendimin se, faturimi i borxhit është i pabazuar dhe është në kundërshtim me nenin 360 par.1 nënpar.1.1 të LPP-së pasi që një kërkesë e tillë është parashkruar, andaj i propozojë gjykatës që të hudhet posht urdheri për përmbarim si i pabazuar për shkak të parashkrimit.

Kreditori në afatin e parashikuar ligjor ka bërë përgjigje në prapësimin e debitorit, duke i propozuar gjykatës që të njëjtin ta refuzoi si të pabazuar për faktin se fillimisht kreditori propozimin për përmbarim e ka filluar duke u mbështetur në dokumentin e besueshëm të parapara me LPP dhe bazuar në gjendjen faktike të konsumit të ujit të paraqitura në ujëmatës në fillim të çdo muaji i dorëzohet konsumatorit faturat origjinale me të dhënat e konsumit, kurse sa i përket parashkrimit këtu nuk kemi të bëjmë me parashkrim, për arsye se borxhi i kërkuar i takon periudhave nga dt.01.01.2021 e gjer me dt.31.10.2022, ndërsa borxhi para dt.01.01.2021 nuk është objekt kontesti. Si provë përgjigjes i bashkëngjesim ekstraktin financiar ku shihet se debitori i ka pranuar faturat dhe periudhat lidhur me borxhin me të cilin ngarkohet, andaj konsideroj se propozimi i kreditorit duhet të përmbushet konform nenit 27 par. 1 dhe 29 par.1.2 dhe 1.3 të LPP-së.

Gjykata Themelore Mitrovicë – Dega në Skenderaj, si përmbarimore, në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit dhe thëniet e cekura në të njëjtin dhe gjeti se i njëjti është i pa bazë. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit nuk tregojnë shkaqet sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilave do të pengohej përmbarimi i lejuar nga kjo gjykatë.

Gjykata pas shikimit të shkresave tjera të lëndës, si dhe sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim kur thirret në atë duke theksuar se faturimi i borxhit është i pabazuar, pretendimet e lartëcekura gjykata i refuzoi si të pa bazuara, për faktin se kreditori propozimin për përmbarim e ka iniciuar në bazë të faturës, e sipas nenit 29 par.1.3 në lidhje me par.3 të LPP-së, fatura konsiderohet dokument i besueshëm dhe është i përshtatshëm për përmbarim, po ashtu në shkresat e lëndës gjendet kartela financiare e konsumatorit që i është bashkëngjitur propozimit për përmbarim ku janë të specifikuar të dhënat si: kreditori, debitori, adresa, data, vendi, sasia e ujit të harxhuar, vlera në euro, pagesat eventuale, si dhe borxhi i përgjithshëm, poashtu në propozimin për përmbarim është specifikuar qart se borxhi i kërkuar është nga dt.01.01.2021 e deri me dt.31.10.2022 në shumën prej 284.67, ndërsa borxhi para kësaj periudhe nuk është objekt kontesti.

Ndërsa sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim se borxhi është parashkruar, gjykata gjeti se të njëjtat pretendime janë të pabazuara, për faktin se kreditori në propozimin për

përmbarrim e ka kërkuar borxhin për periudhën kohore dt.01.01.2021 gjerë më dt.30.10.2022, e duke u bazuar në nenin 360 par.1 dhe 2 e në lidhje me nenin 368 nuk kemi parashkrim të këtij borxhi, për shkak se kreditori me dt.05.12.2022 e ka ngritur propozimin për përmbarrim, e ku është ndërprerë edhe afati i parashkrimit.

Se debitori i obligohet kreditorit si në propozim për përmbarrim këtë fakt gjykata, e mbështetë në nenin 245 par.1 të LMD-së i cili nen parasheh se “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, ndërsa par.2 i po të njëjtit nen parasheh se “Kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonohet me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak”.

Gjykata konfirm nënitet 17 të LPP-së, aplikoj dispozitat ligjore të LMD-së.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë, e konform dispozitave të nenit 3, 17, 29 par.1.3 dhe par.3 69, 71, 73 par. 3 të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore, e në lidhje me nenin 245 par.1 dhe 2, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
PPP.nr.210/2022, dt.16.02.2023

Gj y q t a r i
Avdulla Mecinaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së këtij Aktvendimit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.